



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 22.02.2025

Nr: 141

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**MOS FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË  
DENONCIMIN NR. 30 ID, DATË 18.02.2025, TË REGJISTRIT TË  
DENONCIMEVE, TË PARTISË DEMOKRATIKE/PD**

Sot më datë 22.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

**KËRKUES:** Partia Demokratike

**OBJEKT:** Konstatim i shpërdorimit të burimeve njerëzore për qëllime zgjedhore

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator

**KONSTATOJ:**

Partia Demokratike më datë 18.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 30 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon:

*“Denoncimi për institucionin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizime (AKUK), përhapur në rrjetet sociale përbën shqetësim serioz për ne dhe për qytetarët shqiptarë. Brenda këtij institucioni, Drejtori dhe stafi i tij ka dyshime se janë duke shpërndarë postime me sfond politik në rrjetet e tyre sociale, duke detyruar punonjësit të reagojnë duke dhënë postime ‘like’ dhe koment.”*

Data: 22.02.2025

Nr: 141  
Ora: 12:00



“Për mos fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 30 ID datë 18.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Partisë Demokratike/PD”

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 2, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljet e mundshme.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

### **V E N D O S:**

1. Mos fillim të procedurës administrative të denoncimit me nr. 30, datë 18.02.2025, të Partisë Demokratike.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**